



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:200959

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05753863

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.814/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Perlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurve R. O.dhe M. O., secili veç e veç për shkak të veprës penale “Sulm” nga neni 184 par 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti të Përgjithshme PP/II.nr.1668/22, të datës 07.09.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 28.05.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit nga Prokuroria Themelore në Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit R. O.dhe M. O., të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 30.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. R. O., i lindur më datë.....në Pejë, tani banon në fsh. B. K. Pejë, nga babi..... dhe nëna e vajzërisë, ka të kryer pesë vite të shkollës fillore, i martuar baba i tre fëmijëve, punëtor fizik, i gjendjes se dobët ekonomike-Rast social, i njohur me numër personal, posedon numër të telefonit 043/...-..., i nacionalitetit Rom, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2.M. O., i lindur më datë në Pejë, tani banon në fsh. B. K. Pejë, nga babi dhe nëna.... e vajzërisë, nuk ka shkollë të kryer, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes se dobët ekonomike, i njohur me numër personal, i nacionalitetit Rom, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËN FAJTOR

Për shkak se :

I pandehuri M. O.

I. Me datën 09.08.2022 rreth orës 20:10 min në fsh. C.K. Pejë, pikërisht ne shtëpinë e tij familjare me dashje ka përdorur forcë ndaj të dëmtuarit R. O.– vëllait të tij , në atë mënyre qe pasi që i pandehuri M. shkon tek vendi i lartcekur për të marr rrobat e tij dhe pasi që e kupton se R. i kishte grisur rrobat e tij dhe të njëjtat i kishte hedhur ne koshin e mbeturinave, ne ato momente i pandehuri M. e sulmon të dëmtuarin R. duke e kapur për gjoksi dhe e goditur me grusht, deri sa ndërhyjnë familjaret e tyre dhe i ndajnë,

-me çka ka kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184 par.1 të KPRK-së,

I pandehuri Robert Osmani

II. Me datën 09.08.2022 rreth orës 20:10 min në fsh. C. K. Pejë, pikërisht ne shtëpinë e tij familjare me dashje ka përdorur forcë ndaj të dëmtuarit M. O. – vëllait të tij, në atë mënyre qe pasi që i dëmtuari shkon tek vendi i lartcekur për të marr rrobat e tij, aty del i pandehuri i cili pas një mosmarrëveshje ne mes veti e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me grusht, deri sa ndërhyjnë familjaret e tyre dhe i ndajnë,

-me çka ka kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit R. O. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të pandehurit M. O. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- III.** Obligohen të dënuarit qe secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me dt.07.09.2022 ka ngrit aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.1668/22, kundër të pandehurve R. O.dhe M. O., secili veç e veç për shkak të veprës penale “Sulm” nga neni 184 par 1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 28.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokuroja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe të pandehurit R. O.dhe M. O., në të cilën seancë të pandehurit secili veç e veç u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale qe ju vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit, duke vendosur në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPRK-së gjykata aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi qe është e qartë se kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe provat e pranueshme qe e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit deklaroi “ Pasi që të pandehurit e pranuan fajësinë e ky pranim fajësie gjen mbështetjen në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurit ti shpalle fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethane lehtësuese”.

I pandehuri M. O. deklaroi “Na kemi pas këtë telashe, jemi shty në mes veti mirëpo jemi pajtuar në atë kohë shumë shpejt dhe tashmë jetojm bashkë dhe nuk kemi probleme, më vjen shumë keq që ka ndodhur ai rast”.

I pandehuri R. O.deklaroi “Jemi pajtuar dhe nuk kem telashe, jetojmë bashkë dhe tash konsideroj veten si prind se jam më i madhe dhe prindërit na kanë vdekur, më vjen shumë keq që ka ndodhur ky rast dhe shpresoj se ma nuk do të përsëritet”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074): dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor të pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurve vendosi që të shqiptoj secilit veç e veç që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse të dënuarit nuk do të kryejnë vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, faktin se të pandehurit tashme janë pajtuar dhe keqardhjen e shfaqur nga të pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoi se me shqiptimin e dënimit më kushtëzues ndaj të pandehurve do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikojë në rehabilitimin e të pandehurve, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurve se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryejnë vepër tjetër penale ndaj tyre do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që janë shpallur fajtor të pandehurit është paraparë mundësia e shqiptimit dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.814/22, me datë 30.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.